



N.SH. "Univerzum Audit"

**RAPORTI I AUDITIMIT
TË RAPORTEVE TË DEKLARIMIT FINANCIAR
TË FUSHATËS SË SUBJEKTEVE POLITIKE
Zgjedhjet Lokale 2009**

Prishtinë, Nëntor 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

- I Hyrje
- II Objektivi dhe Fusha e Auditimit
- III Qasja e Auditimit
- IV Përmbledhje e Përgjithshme
- V Vlerësimi i përgjithshëm dhe Rekomandimet
- VI. Raportet e deklarimit financiar sipas Subjekeve Politike dhe Auditorit

LISTA E SHKURTESAVE

ZL	Zgjedhje lokale
KQZ	Komisioni qendror i zgjedhjeve
SKQZ	Sekretariati i KQZ-së
ZRPP	Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim
KKZ	Komisioni Komunal Zgjedhor
SP	Subjekte Politike
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SKK	Standardet Kosovare të Kontabilitetit
DF	Deklaratat Financiare
LSHF	Limiti i shpenzimeve për fushatë
ZK	Zyra Kadastrale
ZRB	Zyra për regjistrimin e Bizneseve
ATK	Administrata tatimore e Kosovës
OJQ	Organizata Joqeveritare

PËRKUFIZIMET

Zgjedhje lokale do të thotë zgjedhjet e Kuvendeve të Komunave dhe Kryetarëve të Komunave;

Periudha e fushatës do të thotë periudha prej tridhjetë ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike e cila përfundon një ditë para ditës së zgjedhjeve;

Përfaqësuesi financiar do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shenimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me Ligjin mbi zgjedhjet dhe Rregullat zgjedhore.

Kontributi do të thotë dhurata, ndihma ose donacioni i cilitdo lloj që i jepet subjektit politik, qoftë në para të gatshme apo në të mira materiale. Kontributi realizohet atëherë kur subjekti politik përfiton nga kontributi;

Fletë bilanci do të thotë deklarimi financiar i subjekteve politike i pasurive, detyrimeve dhe kapitalit ;

Të ardhura do të thotë çdo shumë monetare e pranuar si kuotë anëtarësie ose tarifë; qiraja; kontributet nga jashtë nga individët, bizneset ose organizatat e çfarëdo lloji; donacionet; vlera e kontributeve në formë të mallrave dhe shërbimeve (bamirëse) kontributet dhe çfarëdo pagese për subjektin politik;

Shpenzimi për fushatë do të thotë çdo pagesë e bërë për mallra ose blerje të mallrave, materialeve, punës, shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme, me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në zgjedhje, pavarësisht nëse bëhen për mbështetje të kandidatit të posaçëm, partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare, siç janë shpenzimet për reklamim në mediat e shtypura; prodhimin e spoteve transmetuese; materialet e fushatës, përfshirë pamfletet, posterët, ekspozim të reklamave, përfshirë stendat e afishimit dhe prodhimin e tyre;

Aktiviteti i Fushatës Politike do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet;

Media do të thotë të gjitha televizionet dhe radiostacionet që transmetojnë në territorin e Kosovës dhe të cilët janë të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media, duke përfshirë edhe mediat e shkruara;

Auditor për Fushatë nënkuptohet organizata e cila është e ngarkuar nga Zyra me detyrë specifike të auditojë shpenzimet e fushatës.

I. HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është organ i themeluar në pajtim me Nenin 139. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, organ i përhershëm i pavarur, përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve në Republikën e Kosovës. Ka për detyrë të rregullojë procesin elektoral përmes miratimit të Rregullave Zgjedhore dhe, mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në të gjitha aspektet për të siguruar që zgjedhjet të arrijnë standardet ndërkombëtare.

Është përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Zgjedhje.

Sekretariati i KQZ-së është një trupë teknike, e themeluar nga KQZ-ja për të ndihmuar në kryerjen e përgjegjësiave dhe funksioneve të saj. I zbaton vendimet e KQZ-së dhe përgatitë raporte, rekomandime për vendime të KQZ-së, siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ-në. Pas miratimit nga KQZ-ja, Sekretariati lidhë marrëveshje me palët e treta, në emër të KQZ-së duke u mbështetur në procedurat e themeluara nga KQZ.

Zyrën për regjistrimin e partive politike dhe certifikim e themelon KQZ-ja brenda SKQZ-së.

ZRPPÇ është përgjegjëse për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklaramin financiar.

Zgjedhjet lokale financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Fondet administrohen nga KQZ-ja në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje është i obliguar të përpiloj dhe dorëzojë Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës sipas formës, afateve dhe kritereve të Nenit 40 të “Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës” dhe Nenit 3. të Rregullës Zgjedhore Nr 12/2009. “Mbi Kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklaramin financiar”.

Në këtë raport duhet paraqitur në mënyrën më të saktë të mundur shumat që subjekti politikë i ka shpenzuara gjatë fushatës në Zgjedhjet Lokale 2009 duke ju përmbajtur kritereve të Nenit 39 të “Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës” dhe Nenit 2. të Rregullës Zgjedhore Nr 12/2009. “Mbi Kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklaramin financiar”.

Megjithëse vënia në zbatim e kufizimit të Shpenzimeve është pjesë e rëndësishme e procesit të publikimit financiar, synimi kryesor i publikimit financiar është që nga Subjektet Politike të kërkohen jo vetëm shpenzimet por edhe publikimi i burimeve të të Hyrave të tyre.

II. OBJEKTIVI DHE FUSHA E AUDITIMIT

Objektivi i këtij Raporti të auditimit mbi Deklarimet Financiare të Fushatës të Subjekteve Politike është që publikut t'i paraqiten informatat e transaksioneve financiare të periudhës së fushatës të atyre Subjekteve Politike të cilat kanë garuar në Zgjedhjet lokale 2009, për Kuvendet Komunale dhe për Kryetar Komune. Këto informata i paraqiten publikut për ta bërë procesin politik më transparent dhe Subjektet Politike më të përgjegjshme ndaj votuesve të tyre.

Auditimi i rregullsisë është i definuar si verifikim i deklaratave financiare, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e tyre dhe të dhënave tjera:

- Nëse Subjekti politik mban evidencat adekuate mbi transaksionet financiare;
- Nëse deklaratat financiare janë raporte komplete dhe me kohë;
- Nëse janë respektuar Ligjet dhe Rregullat në fuqi lidhur me raportimin financiar të subjekteve politike;
- Nëse deklaratat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtet financiare për burimet dhe shpenzimet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore;
- Nëse burimet në para dhe natyrë janë raportuar në mënyrë të drejtë;
- Nëse kontributet janë pranuar në pajtim me Ligjin 2004/2;
- Nëse shpenzimet janë raportuar sipas degëve dhe komunave;
- Nëse shpenzimet e raportuara nuk tejkalojnë limitet e parapara sipas komunave dhe i takojnë periudhës raportuese;
- Konstatimi i Subjekteve politike që kanë fituar vende;
- Verifikimi i informatave nga DF te personat e tretë (ATK, ZK, ZRB, Bankat etj);
- Përgaditja e Raporteve paraprake dhe Raportit perfundimtar në formën dhe afatet e parapara
- Shqyrtimi dhe përpunimi i Raporteve Korigjuese të Subjekteve Politike;
- Arritja e kualitetit të auditimit sipas kërkesave të Standardeve ndërkombëtare mbi kontrollin e cilësisë;

III. QASJA E AUDITIMIT

Ne kemi fokusuar qasjen tonë të auditimit në fushat kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit dhe njohja me Ligjet dhe Rregullat Zgjedhore – të kuptojmë plotësisht procesin që ka të bëjë me regjistrim, certifikim, financim, pjesëmarrje, raportim dhe kufizim në burime dhe shpenzime për Subjektet politike.
- Identifikimi i Rrezikut: duke identifikuar subjektin politik, pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale në raundin e parë, dytë dhe të jashtëzakonshme, mënyrën e deklarimeve financiare në formularët përkatës, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në deklaratat financiare ose mospërputhshmëri me ligjin dhe Rregullat.

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës

- Përdorimi i Procedurave plotësuese analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne kemi planifikuar dhe realizuar auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme mbi deklaratat financiare të subjekteve. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit.

Në terme të përgjithshme, (siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalojta, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga deklaratat financiare tek shfrytëzuesit.

Në këtë planifikim kemi pasur parasysh rekomandimet mbi margjinat e gabimeve nga Specifikimet për auditim të Deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike. (Aneksi 3 Specifikimet Teknike).

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e fushatës zgjedhore dhe japin vlerësimin mbi deklaratat financiare të Subjekteve Politike, që kanë të bëjnë me informatat e të hyrave dhe shpenzimeve gjatë fushatës.

IV. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Kompania audituese Ligjore "Univerzum Audit" sipas kontratës 320/10/060/211 të datës 02.09.2010 është angazhuar si Auditor i fushatës për kryerjen e auditimit të Raporteve të Deklarimit financiar të subjekteve politike për zgjedhjet lokale 2009. sipas mënyrës dhe afateve të parapara në Nenin 41.te "Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës", Nenit 4. të Rregullës Zgjedhore Nr 12/2009. "Mbi Kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklaratimit financiar" dhe Nenit 17 dhe 18 të Rregullës Nr.1/2008, "Për regjistrimin dhe financimin e partive politike"

N.SH "Univerzum Audit" ka kryer auditimin e Raportit të Deklarimit financiar të SP për fushatën zgjedhore të Zgjedhjeve lokale 2009.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një vlersim lidhur me raportet e deklaratimit financiar të Subjekteve Politike.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve tona për auditimin e Subjekteve Politike, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar deklaratat financiare të SP, në raport me harmonizimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Kemi vërtetuar se DF janë plotësuar sipas Rregullores 12/2009 dhe Rregullës zgjedhore 10/2009.
- Duke u bazuar në kufizimet e shpenzimeve për fushatën zhdhore 2009, kemi identifikuar limitin e përgjithshëm të shpenzimeve dhe pjesëmarrjen e SP në komunitat përkatëse;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi deklaratat financiare;

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të marrjes së informatave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve, verifikimin fizik dhe vizitave në teren, për të vertetuar vlefshmërinë dhe plotësinë e transaksioneve financiare të raportuara në DF.
- Pajtushmërin mbi vlerësimin e të hyrave dhe shpenzimeve të subjekteve, nëse janë në respektuar obligimet e parapara me Rregullën e KQZ-së Nr. 01/08 dhe Rregullën e UNMIK-ut 2004/2 si e ndryshuar, “Mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale”.

V. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Nga ZRPP-ja janë çertifikuar 79 Subjekte Politike, prej tyre, Raporte të DF për raundin e parë kanë dorëzuar 58 SP.

Në raundin e dytë kanë marrë pjesë 8 SP: SNSD, Rufki Suma, SLS, PDK, LDD, AKR, AAK dhe LDD. Prej tyre Raport të DF nuk kanë dorëzuar : AAK dhe LDK.

Në përsëritjen e raundit të dytë në komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit kanë garuar : LDK dhe PDK. Prej tyre, Raport të DF nuk ka dorëzuar PDK.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme komuna e Istogut- raundi i parë kanë garuar: AKR, LDD, AAK, LDK dhe PDK. Prej tyre, PDK nuk ka dorëzuar raport të DF.

Në zgjedhjet në balotazh për kryetar të komunës së Istogut, pjesmarrës kanë qenë:PDK dhe LDK. Prej tyre, PDK nuk ka dorëzuar raport të DF.

Vlerësimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës:

Në DF, auditimi ynë ka identifikuar një numër të caktuar të mangësive në fushën e mjeteve, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve të prezantuara, të cilat vëjnë në dyshim plotësinë, kualitetin dhe besueshmërinë e raportit të përgjithshëm të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike.

SP të cilat nuk kanë dorëzuar fare Deklaratat Financiare në SKQZ janë:

Demokracia e Re e Kosovës-DRK, Koalicioni për Prizrenin, Partia Liberale e Kosovës- PLK, Partia Demokratike për Integrim-PDKI, Gragjanska Inicijativa Orahovac-V.Hoça, Boshnjaqka Unija Kosova-BUK, Srpski Demokratski Pokret, Inicijativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, JedinstvenaSirinička Zhupa-JSZH, Za Bolju Budućnost Kosova-ZBB, Lista Za Evropko Gnjilane, Bajram Islami, Sabahudin Cirikoviç, Mexhit Foniqi, Adem Haxhi Gashi, Naim Mustafa, Hasan Bilalli, Sakip Makasqi.

Rrjedhimisht një numër i konsiderueshëm i SP kanë dorëzuar DF të pakompletuara apo me shënime të pasakta, duke mos deklaruar për të gjitha raundet e zgjedhjeve, degët dhe komunat ku kanë garuar.

Mos dorëzimi i raporteve (Deklaratave Financiare) apo dorëzimi i tyre me mungesë të shënimeve financiare, si dhe dështimi në publikimin e origjinës për të hyrat dhe shpenzimet nga SP, janë

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës

çështje mjaft të ndieshme që kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm. Si rrjedhojë e saj ka qenë ndërrimi i shpeshtë i zyrtarëve financiar në SP, mungesa e trajnimit adekuat të tyre si dhe mungesa e zyrtarit financiar pranë ZRPPÇ, përgjegjësi e së cilës është kontrollimi i deklaratave financiare të SP.

Një numër i madh i subjekteve politike kanë bërë gabimet e njëjta gjat përpilimit të DF.

Ndër gabimet më të shpeshta që janë vërejtur ishin:

- Përlllogaritje jo e saktë e Salldos në Bilanc;
- Shpenzimet e regjistruara në shumicën e rasteve janë të pa kategorizuara, të pa mbledhura si total, si dhe në shumicën e rasteve edhe pa dokument burimor (fatura në vlerë mbi 100 €);
- Në të shumtën e deklaratave financiare ku paraqiten donacionet dhe kontributet në të holla mungojnë iformatat, ose janë shënuar me informata jo të plota, si dhe janë vërejtur vlera të pranuar mbi 1,000.00 € brenda një dite nga i njëjti donatorë;
- Donacionet në të holla të paraqitura nga shumica e subjekteve politike nuk kanë sjellur dokument burimorë (gjendja e llogarisë bankare ose dëftesat e pagesave);
- Ndonëse SP gjatë fushatës elektorale kanë angazhuar aktivistë vullnetarë, shfrytëzimin gratis të lokaleve për zyrë, hapsirave për mitingje, përdorim të veturave, derivateve, shërbimet e këngëtarëve për zbavitje etj, tregon se deklarimi i kontributeve në natyrë në DF është nënvlersuar.

Mos deklarimi i saktë i shpenzimeve të ndodhura vë në dyshim paraqitjen e drejtë të të hyrave të realizuara për periudhën e fushatës elektorale.

Testet tona gjatë auditimit kanë treguar se shumica e Subjekteve Politike kanë nënvlerësuar edhe shpenzimet në kategori të ndryshme ekonomike:

Spotet televizive , të radios dhe billbordat

Nga informatat e mbledhura nga stacionet TV dhe Radiove kombëtare, me transmetim në tërë teritorin e Kosovës, lidhur me shpenzimet e fushatës së SP, kemi arritur në përfundim se ato nuk përputhen me vlerat e deklaruara nga SP, gjegjësisht janë nënvlerësuar.

Shpenzimet e billbordave të paraqitura në tërë Kosovën janë deklaruar me vlera shumë të ulta ose nuk janë deklaruar fare nga shumica e SP.

Qiraja për zyrë

Në shumicën e deklaratave financiare të SP nuk ka të deklaruara shpenzime të qirasë dhe objekte-zyrë në pronësi, si për qendrat ashtu edhe për degët, të cilat i posedojnë qoftë në shfrytëzim ose si pronë të tyre. Po ashtu inventari, veturat ose qfardo lloj pasurie tjetër e SP nuk është deklaruar fare, ose është deklaruar në vlera shumë më të ulta dhe pa dokument burimor.

Pagat dhe vëzhguesit

Pagat e të punësuarve nga shumica e SP nuk janë deklaruar fare, qoftë si shpenzim i paguar ose si Kontribut në Natyrë nëse ata punojnë në baza vullnetare. Po ashtu shumica e SP edhe pagat e vëzhguesve (vullnetarë) nuk i kanë deklaruar qoftë si shpenzim apo si Kontribut në Natyrë.

Transporti

Shumica e SP kanë dështuar në deklarimin e veturave në regjistrin e tyre të pasurisë. Është evidente se SP gjatë periudhës së fushatës kanë shfrytëzuar vetura qoftë të marra me qira ose të dhëna në shfytëzim në baza vullnetare, të cilat është dashur të deklarohen si shpenzim i qirasë së veturave dhe Kontribut në Natyrë duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut.

Xhiorlogaritë bankare

Shumica e Subjekteve politike nuk kanë prezentuar gjendjen e llogarisë bankare për periudhën e fushatës prej nga do të kishim marrur informacione për burimet e mjeteve dhe pagesat e kryera nga SP.

Rekomandimet

Bazuar në dobësitë e lartshënuara, ne rekomandojmë Subjektet Politike që raportet financiare ti përgatisin në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Subjektet Politike duhet që Deklaratat Financiare ti përgadisnin me të gjitha informacionet e nevojshme, përfshirë këtu edhe shpalosjet lidhur me transaksionet e ndodhura nëpër ato degë të SP në të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në fushatën zgjedhore.

Deklaratat financiare duhet të janë raporte komplete dhe me kohë, në mënyrë që ato të pasqyrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtet financiare për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura gjatë fushatës zgjedhore;

Të gjitha SP duhet ti përmbahen ligjeve dhe rregulloreve të KQZ-së sipas të cilave përcaktohen procedurat dhe qështjet financiare, veqanërisht respektimin e limiteve të shpenzimeve të ndodhura, raportim të plotë të burimeve në para dhe natyrë, si dhe kontributet tjera të pranuar.

Të sigurohen të gjitha SP që zyrtarët e tyre financiar kanë trajnim adekuat për evidentimin dhe përpilimin e deklaratave financiare

Rekomandohet Zyra për regjistrim të partive politike dhe çertifikim, që sipas Rregullës nr.01/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, të bëjë kontrollimin e secilit raport financiar të SP dhe rezultatet paraprake të këtij kontrolli t'ia paraqesë organit më të lartë ekzekutiv të partisë politike, duke përfshirë edhe listën e gabimeve apo lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit.

VI. RAPORTET E DEKLARIMIT FINANCIAR SIPAS SUBJEKEVE POLITIKE DHE AUDITORIT

Sipas Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në nenin 39.2 dhe 40.1 parashihen që :

39.2 KQZ-ja përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së.

40.1 Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.

Formularët e Deklaratave Financiare të fushatës së subjekteve politike përmbajnë:

B. MJETET

C. LLOGARIT QË MERREN DHE OBLIGIMET (borgjet e SP)

D. HUATË (borxhet ndaj bankave, institucioneve financiare ose kreditorëve individual)

E. TË HYRAT PËR PERIUDHËN E RAPORTIMIT

F. SHPENZIMET (Bashkangjitur dokumentacionin plotësues)

FLETË BALANSI DHE DEKLARATA E FITIMIT/HUMBJES

SHTOJCA A. DONACIONET DHE KONTRIBUTET NË TË HOLLA (nëse vlera e të gjitha kontributeve nga një burim i vetëm i kalon 100euro)

SHTOJCA B: KONTRIBUTET NË NATYRË NË MALL DHE NË SHËRBIME (nëse vlera e gjithëmbarshme e vlerësuar e të gjitha kontributeve nga një burim i vetëm i kalon 100euro)

SHTOJCA C: VLERA E GJITHËMBARSHME E PAGESAVE (vlera e gjithëmbarshme e të gjitha pagesave nga partia ndaj një pranuesi të vetëm

Në vijim po i paraqesim gjendjet e Deklaratave Financiare për çdo Subjekt Politik.

Për më tepër në detaje mund t'iu referoheni Raporteve Individuale për çdo SP.

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**KOALICIONI “VAKAT” NBS, DSV, DBS**

Selia: Prizren (Pejë, Prizren, Dragash);
Degët e subjektit : NBS ka degë në Pejë dhe Istog,
 DSB ka degë në Prizren,
 DSV ka degë në Dragash,
Zgjedhjet Lokale 2009: Në raundin e parë ka garuar në Dragash, Istog,
 Leposaviq, Pejë dhe Prizren;
Në raundet tjera: Nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1. Të raportuara	20,411.15 €
2. Sipas Auditorit	20,411.15 €
3. Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	171,789.00 €
2. Janë raportuar	20,411.15 €
3. Sipas Auditorit	20,411.15 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara dhe të pambështetura.
 Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Ka pas donacione brenda një dite mbi 1,000.00€ (DSB)
- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B janë të raportuara por pa dokumentacion mbështetës;
- Detyrime në Tabelën C nuk janë të paraqitura;
- Të hyrat nga Kuvendi janë të shpalosura gabimisht në Shtojcën A;
- Të hyrat nga kuvendi nuk janë të mbështetura;
- Shpenzimet e prezantuara nuk janë të ndara sipas komunave ku subjekti ka garuar;

GRADJANSKA INICIATIVA ZA PROMENE “ZAVICAJ”

Selia: Pasjan, Gjilan
Degët e subjektit : - / -
Zgjedhjet Lokale 2009 Në raundin e parë ka garuar në Komunën e Gjilanit,
Në raundet tjera: Nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Shpenzimet e Subjektit:**

1. Janë kufizuar në	50,146.00 €
2. Janë raportuar	0.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin pa të dhëna.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, nuk janë deklaruar;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para, nuk është plotësuar;
- Shtojca B nuk është plotësuar;
- Shtojca C nuk është plotësuar;
- Shpenzimet, Pjesa F, nuk janë raportuar;
- Dëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 €. nuk janë të prezantuara;
- Nuk është prezantuar pasqyra bankare që mbulon periudhën e fushatës apo pohim mbi mosposedimin e saj;
- Fletë bilanci dhe deklaratat e fitimit/humbjes nuk është plotësuar;

SRPSKI POKRET OTPORA- SPOT

Selia: Graçanicë
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë kanë garuar në Komunën e Graçanicës.
Në raundet tjera nuk kanë garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00
2.Sipas Auditorit	0.00
3.Diferenca	0.00

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	8,460.00 €
2. Janë raportuar	7,790.00 €
3. Sipas Auditorit	7,770.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00

Dobësitë kryesore të identifikuarra janë si në vijim:

- Mjete-nuk ka të deklaruara fare
- Detyrimet nuk ka të deklaruara.
- Të hyra nuk ka të deklaruara fare.
- Për shpenzimet e derivateve nuk ka informata për veturat si pasuri, ose kontribut në natyrë.
- Shpenzimet deklarohen si të paguara, pa dëshmi pagese ose burim të mjeteve financiare.
- Fletë bilanci dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat e deklaruara në shtojcën A dhe B nuk ka të deklaruara fare.

INCIATIVA QYTETARE E PODUJEVËS - IQP

Selia: Podujevë, Rr. Zahir Pajaziti p.n.
Degët e subjektit : - / -
Zgjedhjet Lokale 2009: Në raundin e parë ka garuar në Komunën e Podujevës,
Në raundet tjera: Nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	2,100.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	2,100.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	39,811.00 €
2.Janë raportuar	2,100.00 €
3.Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me një pjesë të të dhënave të pambështetura.
 Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, janë të raportuara edhe në shuma nën 500€, por nuk janë të kompletuara;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, janë deklaruar por nuk janë të mbështetura;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para, është plotësuar por nuk është kompletuar me shënime obligative (numrin personal) për kontribuuesin.
- Kontributet në para (E.2.) nuk barazohen me ato të shpalosura në Shtojcën A;
- Shtojca B është plotësuar me të njëjtat shënime si Shtojca A;
- Shtojca C nuk është plotësuar;
- Shpenzimet, Pjesa F, janë raportuar por nuk janë të mbështetura;
- Dëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 €. nuk janë të prezantuar;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat komplete bankare që mbulojnë periudhën e fushatës apo pohim mbi mosposedimin e saj;
- Fletë bilansi dhe deklarata e fitimit/humbjes është prezantuar por është e pabalancuar;

VIDOVDAN-2009

Selinë e ka të vendosur në : Graçanicë
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë: kanë garuar në Komunën e Graçanicës.
Në raundet tjera : nuk kanë garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Shpenzimet e Subjektit:**

1. Janë kufizuar në	8,460.00 €
2. Janë raportuar	0.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin pa të dhëna.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjete-nuk ka të deklaruar fare
- Detyrimet dhe hua- nuk ka të deklaruar fare.
- Të hyra nuk ka të deklaruar fare.
- Shpenzime nuk ka të deklaruar fare.
- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat e deklaruar në shtojcën A dhe B nuk ka të deklaruar fare.

GRAGJANSKA INICIATIVA ZA BUDUČNOST KOSOVA-GIZABK**Selia:**

Në zgjedhjet Lokale 2009,

Në raundet tjera:

Kastriot.
në raundin e parë kanë garuar në Komunën e Kastriotit
nuk kanë garuar

Te hyrat e Subjektit:

1. Të raportuara	0.00 €
2. Sipas Auditorit	0.00 €
3. Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	10,770.00 €
2. Janë raportuar	0.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin pa të dhëna.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjete nuk ka të deklaruar fare
- Detyrimet dhe hua nuk ka të deklaruar fare.
- Të hyra nuk ka të deklaruar fare.
- Shpenzime nuk ka të deklaruar fare.

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës

- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat nga donacionet dhe kontributet në të holla dhe në natyrë- shtojca A dhe B nuk ka të deklaruar fare.

GJURGJEVDAN HERDELEZI-TOCAK

Selia: Graçanicë
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë kanë garuar në Komunën e Graçanicës.
Në raundet tjera: nuk kanë garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	8,460.00 €
2.Janë raportuar	6,700.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me një pjesë të të dhënave të pambështetura.
 Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjete nuk ka të deklaruar fare
- Detyrimet nuk ka të deklaruar.
- Të hyra nuk ka të deklaruar fare.
- Shpenzimet e deklaruar janë pa dokument burimorë dhe pa mbulesë financiare.
- Për shpenzimet e derivateve nuk ka informata për veturat si pasuri, ose kontribut në natyrë.
- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat e deklaruar në shtojcën A dhe B nuk ka të deklaruar fare.

GRAGJANSKA INICIJATIVA EVROPSKI POKRET- GIEP

Selia F.Partesh, Komuna e Gjilanit.
Degët e subjektit : F.Partesh, Komuna e Gjilanit .
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë kanë garuar në Gjilan, Fshati Partesh,
Në raundet tjera nuk kanë garuar;

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Të hyrat e Subjektit:**

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	50,146.00 €
2. Janë raportuar	4,200.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjete nuk ka të deklaruar nga ana e SP.
- Detyrime nuk janë të raportuara fare
- Të hyrat për periudhën e raportimit Pjesa E, është deklaruar pa të dhëna ;
- Donacione dhe kontribute në të holla dhe në natyrë nuk ka të deklaruar.
- Shtojca C-vlera e gjithmbarshme e pagesave , nuk ka informata fare;
- Dhëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 euro. nuk janë të prezantuara;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

GRAGJANSKA INICIJATIVA ZA OPSTINU RANILUG-GIZOR**Selia:**

**Në zgjedhjet Lokale 2009,
Në raundet tjera**

Ranilug
në raundin e parë kanë garuar në Komunën e Ranilugës.
nuk kanë garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	2,671.00 €
2.Janë raportuar	2,435.00 €
3.Sipas Auditorit	1,785.00 €
4. Te jkallim i konstatuar	0.00 €

Vlerësimi i deklaratave financiare:

Në Deklaratat financiare, auditimi ynë nuk ka identifikuar ndonjë mangësi në raportin financiarë i cili do të kishte ndikuar materialisht në kualitetin dhe besueshmërinë e raportit të përgjithshëm të deklaratimit financiar të fushatës së subjektit politike .

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:**

- Mjete nuk ka të deklaruar nga ana e SP.
- Detyrimet nuk janë të raportuara fare
- Të hyrat për periudhën e raportimit Pjesa E, është deklaruar pa të dhëna ;
- Shpenzimet e karburantëve në vlerë prej 650.00 € nuk janë pranuar nga ana e jonë pasiqë nuk i takojnë periudhës së fushatës.
- Donacione dhe kontribute në të holla dhe në natyrë nuk ka të deklaruar.
- Shtojca C-vlera e gjithmbarshme e pagesave , nuk ka informata fare;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

STRANKA DEMOKRATSKIH PROMJENA-SDP**Selia:**

**Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë:
Në raundet tjera:**

Pejë,
ka garuar në Istog dhe Pejë.
nuk ka garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	2,500.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	2,500.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	67,641.00 €
2.Janë raportuar	3,504.10 €
3.Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

-Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjetet ndryshimet në vlerat e mjeteve në fillim dhe në fund nuk kanë dokument burimorë..
- Detyrimet nuk janë të raportuara, ndërsa huatë janë në vlerë prej 1,007.00 € pa dokument burimorë.
- Të hyrat në E2,E3 Donacionet dhe Kontributet në të holla vlerë prej 2,300.00 € si dhe Kontributet në Natyrë në vlerë prej 200.00 € nuk janë dëshmuar me dokument burimorë.
- Të gjitha shpenzimet e raportuara nuk kanë dokument burimorë(fatura mbi 100 €)
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat e deklaruar në shtojcën A nuk kanë dëshmi me dokumente burimore.

KANDIDAT I PAVARUR-ABDYL BAJRAMI**Selia:****Degët e subjektit :**

**Zgjedhjet Lokale 2009:
Në raundet tjera:**

Viti,
Në raundin e parë ka garuar në Komunën e Vitisë,
Nuk ka garuar;

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Të hyrat e Subjektit:**

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	22,910.00 €
2.Janë raportuar	0.00 €
3.Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin pa të dhëna.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, janë të raportuara me zero;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, janë të raportuara me zero;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para, është plotësuar me zero;
- Shtojcat B dhe C të DF nuk janë plotësuar;
- Shpenzimet, Pjesa F, nuk janë raportuar;
- Dëshmitë mbi shpenzimet në shuma mbi 100 €. nuk janë të prezantuar;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës apo pohimi mbi mosposedimin e llogaris bankare
- Nga verifikimet tona në teren është konstatuar se kandidati nuk ka bërë fare fushatë, prandaj edhe deklaratimet i ka dorëzuar me zero.

KANDIDAT I PAVARUR-SAMI TAC**Selia:**

Zgjedhjet Lokale 2009,

Në raundet tjera:

Mamushë
në raundin e parë ka garuar në komunën e Mamushës
nuk ka garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	1,500.00 €
2.Janë raportuar	2,920.00 €
3.Sipas Auditorit	2,720.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	1,420.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**-Dobësitë kryesore të identifikuara janë si në vijim:**

- Mjete nuk ka të deklaruar fare.
- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Shpenzimet e deklaruar janë për 200.00 € më të larta se shpenzimet e verifikuara, si rezultat i mungesës së dëshmisë për qira të lokalit.
- Donacionet dhe Kontributet në të holla dhe në natyrë nuk ka të deklaruar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhen e fushatës;

KANDIDAT I PAVARUR -AZIZ BICI

Selia:	Mazgiti, Komuna e Obiliqit,
Degët e subjektit :	- / -
Zgjedhjet Lokale 2009:	Në raundin e parë ka garuar në Komunën e Obiliqit,
Në raundet tjera:	Nuk ka garuar;
Të hyrat e Subjektit:	
1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €
Shpenzimet e Subjektit:	
1. Janë kufizuar në	10,770.00 €
2.Janë raportuar	320.00 €
3. Sipas Auditorit	120.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	200.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, nuk janë të raportuara;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para, nuk është plotësuar;
- Shtojcat B dhe C nuk janë bashkangjit;
- Shpenzimet, Pjesa F, janë raportuar vetëm në dy pozicione;
- Dëshmitë mbi shpenzimet në shuma mbi 100 €. nuk janë të prezantuar të gjitha;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës apo pohimi mbi mosposedimin e llogaris bankare;

KANDIDAT I PAVARUR -FAIK MIFTARI

Zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë ka garuar në komunën e Prizrenit
Në raundet tjera: nuk ka garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	1000.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	1000.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	75,576.00 €
2.Janë raportuar	1000.00 €
3.Sipas Auditorit	739.00 €
4.Tejkallim i konstatuar	0.00 €

-Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjete ka të deklaruar vetëm në pozicionin e parave të gatshme e plotësuar gabim për periudhën në fund.
- Detyrime nuk ka të deklaruar.
- Shpenzimet nuk janë të specifikuar sipas kategorive..
- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Të hyrat e deklaruar në shtojcën A nuk kanë dokument burimor, dëftesë pagese ose informatë nga llogaria bankare.
- Shtojca C është e plotësuar gabim.

KANDIDAT I PAVARUR- RUFKI SUMA

Selia: Hani i Elezit
Zgjedhjet Lokale 2009: në raundin e parë ka garuar në komunën e Hanit të Elezit

Në raundet tjera: Ka garuar në raundin e dytë prap në komunën e Hanit të Elezit

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	4,219.00€
2.Janë raportuar	6,610.96 €
3.Sipas Auditorit	6,610.00 €
4.Tejkallim i konstatuar	2,391.96 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:**

- Deklarata financiare nuk ka datë të raportimit
- Mjete nuk ka të raportuara fare
- Të hyrat nga Donacionet dhe Kontributet në të holla dhe në Natyrë , nuk janë deklaruar fare.
- Detyrimet dhe Huatë në pjesën C dhe D nuk janë të raportuara.
- Shpenzimet, formulari i shpenzimeve është i pa mbledhur në vlerën totale.
- Fletë bilansi është i pabalansuar
- Mungon xhirrollogaria dhe dëshmia e pagesave.

NARODNA CRNOGORSKA PARTIJA KOSOVA

Selia: Çagllavicë, Prishtinë
Degët e subjektit : Prishtinë dhe përfaqësues në Deçan, Leposaviq dhe Lipjan.

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	200.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	200.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	54,437.00 €
2. Janë raportuar	200.00 €
3.Sipas Auditorit	200.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.
 Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Të hyrat nuk janë shpalos në Shtojën A;
- Shtojca B dhe C nuk janë deklaruar;
- Nuk ka plotësuar deklaratën e humbjes dhe profitit;
- Nuk ka pasqyre bankare;

BASHKIMI DEMOKRATIK I ASHKALIVE

Selia: Fshati Dubravë, Ferizaj
Degët e subjektit : Subjekti ka 9. degë të hapura.

Zgjedhjet Lokale 2009: Në raundin e parë ka garuar në 9 komuna,

Në raundet tjera: Nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	735.25 €
2.Sipas Auditorit	2,140.25 €
3.Diferenca	1,405.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Shpenzimet e Subjektit:**

1. Janë kufizuar në	234,526.00 €
2. Janë raportuar	735.25 €
3. Sipas Auditorit	2,140.25 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Shtojca B është deklaruar me të dhënat e njëjta me ato të Shtojcës A;
- Shtojca C është bashkëngjitur pa shënime;
- Nuk janë përpunuar të gjitha transaksionet e realizuara, mes banke, në periudhën raportuese;

LËVIZJA PËR BASHKIM-LB

Selia:

Prishtinë, "Aktash" rr Agim Ramadani A2-1

Në zgjedhjet Lokale 2009,

në raundin e parë

kanë garuar në Komunën e Kastriotit dhe të Vushtrisë

Në raundet tjera:

nuk kanë garuar

Të hyrat e Subjektit:

1. Të raportuara	10,500.00 €
2. Sipas Auditorit	0.00 €
3. Diferenca	10,500.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	44,173.00 €
2. Janë raportuar	8,810.00 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- Mjetet në Pjesën B nuk janë të raportuara fare.
- Detyrimet dhe huatë C dhe D, nuk ka vlera të raportuara.
- Shpenzimet në vlerë të gjithmbarshme prej 8,810.00 € -nuk janë të mbështatura me dokument burimor faturat.
- Fletë bilansi është i pa balansuar.
- Donacionet dhe Kontributet në të holla janë deklaruar por pa dokument burimorë.
- Të hyrat nga antarësia dhe Kontributet në natyrë janë deklaruar si të hyra ndërsa shtojca B nuk është plotësuar me informata mbi kontribuesin.
- Shtojca C, nuk ka informata fare;
- Dëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 eur. nuk janë të prezantuara;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

SAVEZ NEZAVISNIH SOCIALDEMOKRATA KOSOVA I METOHIJE

Selia: Graqanicë;
Degët e subjektit : Ka të hapura 5 degë;
Zgjedhjet Lokale 2009: Në ka garuar në dy raunde në komunën e Novobërdës;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	4,288.00 €
2. Janë raportuar	0.00 €
3.Sipas Auditorit	0.00 €
4.Te jkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin pa të dhëna.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Të hyrat e periudhës raportuese (Tabela E) nuk janë raportuar;
- Shtojca A, B dhe C janë pa të dhëna;
- Shpenzime të periudhës raportuese (Tabela F) nuk janë raportuar;
- Nuk është paraqit deklarata e fitimit dhe humbjes
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË- LDD

Selia: Velani, Prishtinë
Degët e subjektit : Subjekti ka 16. zyra të partisë.

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	16,200.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	16,200.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	798,209.00 €
2.Janë raportuar	16,189.00 €
3. Sipas Auditorit	16,192.70 €
4. Te jkallim i konstatuar	0.00

€SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Vlerësimi i deklaratës financiare**

- Për raundin e dytë ka raportuar me vonesë më 18.02.2010;
- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara për asnjë raund;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, janë deklaruar në poz. E.2. Donacionet në para, janë shpalos në Shtojën A, por nuk janë të mbësht-etura me dëftesa mbi pranimin, nga do shihet personi pranues në emër të subjekt;
- Shtojcat B nuk është bashkangjitur;
- Shpenzimet e prezantuara nuk janë të ndara sipas komunave ku subjekti ka garuar;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

PARTIA EKOLOGJIKE E KOSOVËS

Selia: Prishtinë.
Zgjedhjet Lokale 2009, raundi parë ka garuar në komunën e Kastriotit
Në raundet tjera: nuk ka garuar

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	1,209.00 €
2.Sipas Auditorit	2,409.00 €
3.Diferenca	1,200.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	10,770.00 €
2. Janë raportuar	2,361.95 €
3. Sipas Auditorit	2,361.95 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

Dobësi kryesore e identifikuar :

- Mjete nuk ka të deklaruara fare
- Të hyrat në E1 janë më të ulta se të hyrat në Shtojcën A-Donacionet dhe Kontributet në të holla për 1,200.00 €
- Kontribute në Natyrë nuk ka të deklaruara fare.
- Fletë bilansi nuk paraqet një gjendje reale duke pasur parasysh të hyrat e deklaruara me vlerë të gabuar.

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**SRPSKA KOSOVSKO METOHLJSKA STRANKA**

Selia: Batuse, Çagllavicë;
Degët e subjektit : Ka të hapura 8 degë;
Zgjedhjet Lokale 2009: Në raundin e parë ka garuar në Graçanic dhe Ranilluk
Në raundet tjera nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	4,400.00 €
2.Sipas Auditorit	0.00 €
3.Diferenca	4,400.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	11,131.00 €
2. Janë raportuar	4,400.00 €
3. Sipas Auditorit	4,400.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.
 Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Dokumentet mbështetëse të Shtojcës A nuk janë prezantuar;
- Shtojca B dhe C janë pa të dhëna;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat komplete bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;
- Në DF nuk janë përpunuar të gjitha transaksionet e realizuara mes llogarisë bankare

SRPSKA NARODNA STRANKA -SNS

Selia: Prishtinë,
Degët e subjektit : Graçanicë, Vushtrri, Lipjan, Mitrovicë.
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë kanë garuar në Komunën e Vushtrrisë dhe
 Graçanicës;
Në raundet tjera nuk kanë garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00
2.Sipas Auditorit	0.00
3.Diferenca	0.00

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	41,863.00 €
2.Janë raportuar	4,955.00 €
3.Sipas Auditorit	0.00 €
4.Tejkallim i konstatuar	0.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:**

- SP ka raportuar vetëm për shpenzimet e një dege-Lipjan, ndërsa për degët e tjera nuk ka raportuar.
- B-Mjetet nuk ka të raportuara fare;
- C-Detyrimet, nuk ka të raportuara fare.
- D-Huatë nuk ka të raportuara fare.
- E-Të hyrat për periudhën e raportimit Pjesa E1,E2,E3,E4, nuk ka raportuara fare.
- F-shpenzimet janë raportuar për degën dhe për qendrën, pa dëshmi mbshtetëse.
- Shpenzimet janë deklaruar si të paguara pa burim të mjeteve financiare.
- Dëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 eur. nuk janë të prezantuara;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

PARTIA REFORMISTE -ORA**Selia:**

Prishtine, rr. Ulpiane k1 nr.10.

Degët e subjektit:Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Lipjan, Prishtinë, Gjiilan.**Në zgjedhjet Lokale 2009,** në raundin e parë kanë garuar në këto Komuna:

Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Lipjan, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Ferizaj.

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	31,509.00 €
2.Sipas Auditorit	31,509.00 €
3.Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	464,269.00 €
2.Janë raportuar	23,296.37 €
3.Sipas Auditorit	23,296.37 €
Tejkalim i konstatuar	0.00 €

Vlerësimi i deklaratave financiare:

Në Deklaratat financiare, auditimi ynë nuk ka identifikuar mangësi në fushën e të hyrave dhe shpenzimeve të prezantuara, të cilat do të kishin ndikim material në kualitetin dhe besueshmërinë e raportit të përgjithshëm të deklarimit financiar të fushatës të subjektit politik .

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**SRPSKA DEMOKRATSKA STRANKA KOSOVA I METOHIJE****Selia:**

Çagllavicë, Prishtinë

Degët e subjektit :

Prishtinë, Obiliç, Lipjan, Rahovec;

Të hyrat e Subjektit:

1. Të raportuara	0.00 €
2. Sipas Auditorit	0.00 €
3. Diferenca	0.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	109,087.00 €
2. Janë raportuar	13,637.95 €
3. Sipas Auditorit	0.00 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, janë të raportuara por janë të pakompletuara;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, nuk janë të deklaruara;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para, nuk është plotësuar;
- Shtojca C nuk është plotësuar;
- Shpenzimet, Pjesa F, janë raportuar në DF, nuk janë të mbështetura;
- Dëshmitë që mbështesin shpenzimet në shuma mbi 100 €. nuk janë të prezantuar;
- Shpenzimet e prezantuara nuk janë të ndara sipas komunave ku subjekti ka garuar;
- Nuk janë prezantuar pasqyrat komplete bankare që mbulojnë periudhën e fushatës;

GRADJANSKA INICIJATIVA GORE**Selia:**

Dragash,

Degët e subjektit : - / -**Zgjedhjet Lokale 2009:**

Në raundin e parë ka garuar në Komunën e Dragashit,

Në raundet tjera:

Nuk ka garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1. Të raportuara	3,763.92 €
2. Sipas Auditorit	3,763.92 €
3. Diferenca	0.00 €

Auditimi i Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës**Shpenzimet e Subjektit:**

1. Janë kufizuar në	19,614.00 €
2. Janë raportuar	3.536.79 €
3. Sipas Auditorit	3.536.79 €
4. Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna të pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Pjesa e detyrimeve, Tabela C dhe D, nuk janë të plotësuata;
- Të hyrat për periudhën e raportimit pjesa E, janë deklaruar te Pozicioni E.2.por duhet të jenë në pozicionin E4. pasi që paraqesin të hyrat e alkokuara nga Kuvendi;
- Shtojca A, mbi kontribuuesit në para është plotësuar gabimisht pasi që ato paraqesin para të alokuara nga Kuvendi, e nuk janë kontribute te personave fizikë,
- Shtojcat B dhe C të DF janë pa të dhëna;

PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS

Selia:

Ferizaj

Degët e subjektit :

Ferizaj, Shtime, Suharekë, Prizren, Lipjan, Fushë
Kosovë, Obiliq, Vushtrri, Gjakovë;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	0.00 €
2.Sipas Auditorit	9,460.00 €
3.Diferenca	9,460.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1. Janë kufizuar në	330,926.00 €
2. Janë raportuar	5,270.40 €
3. Sipas Auditorit	10,170.40 €
4.Tejkallim i konstatuar	0.00 €

SP ka dorëzuar raportin me të dhëna te pakompletuara.

Zyra e Regjistrimit të Partive Politike ka pranuar raportin në atë formë.

Vlerësimi i deklaratës financiare

- Mjetet dhe detyrimet, në Pjesën B dhe C, nuk janë të raportuara;
- Ka pasur kontribut në natyrë në vlerë 160.00€ të dlin nuk e ka prezantuar te Shtojca B;
- Në shpenzime nuk e ka përfshi pagesën e gjobës për KZAP(4,900.00€);
- Shpenzimet e prezantuara nuk janë të ndara sipas komunave ku subjekti ka garuar;
- Nuk janë prezantuar të gjitha transaksionet e realizuara, mes banke në periudhën raportuese;

PARTIA E DREJTËSISË- PD

Selia: Prishtinë,
Në zgjedhjet Lokale 2009, në raundin e parë kanë garuar në këto Komuna:
 Gjakovë, Gllogovc, Gjilan, Dragash, Istog, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq,
 Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Suahrekë, Ferizaj, Vushtrri.
Në raundet tjera nuk kanë garuar;

Të hyrat e Subjektit:

1.Të raportuara	33,990.00 €
2.Sipas Auditorit	28,888.00 €
3.Diferenca	5,102.00 €

Shpenzimet e Subjektit:

1.Janë kufizuar në	684,071.00 €
2.Janë raportuar	34,755.32 €
3. Sipas Auditorit	33,990.00 €
4.Tejkalim i konstatuar	0.00 €

-Dobësitë kryesore të identifikuar janë si në vijim:

- SP nuk ka raportuar sipas degëve dhe komunave ku ka garuar.
- Mjetet ndryshimet në vlerat e mjeteve në fillim dhe në fund nuk kanë dokument burimorë..
- Detyrimet nuk janë të raportuara, ndërsa huatë janë në vlerë prej 765.32 € pa dokument burimorë(p.sh. kontrata e qirasë).
- Fletë bilansi dhe deklaratat e fitimit dhe humbjes nuk janë balansuar.

